

SHOQERIA "TERMOCENTRALI " Sh.a

PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

VLORE

(Shumat janë të shprehura në Lek)

I. BILANCI FINANCIAR

PASQYRA EPOZICIONIT FINANCIAR "TEC.VLORE" sh.a

		<i>Per vitin e mbyllur ne</i>	<i>Per vitin e mbyllur ne</i>
		<i>31.12.2011</i>	<i>31.12.2010</i>
AKTIVET	Ref:		
Aktivët afatgjatë		1,457,166,856	989,884,927
Aktivët afatgjatë materiale		23,434,446	26,000,906
Investime Proccs		1,433,732,410	963,884,021
Aktivë të qendrueshme në magazine	4	0	0
Aktivët afatgjatë jomateriale		-	-
		1,457,166,856	989,884,927
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë	3	1,117,919,474	1,463,915,510
Llogari të arketueshme tregëtare			
Llogari të arketueshme e të tjera	2	449,569,443,32	483,507,004
Mjetet monetare në arkë e në banke		10,177,239	18,977,854
		1,577,666,156	1,966,400,369
Totali i aktiveve		3,034,833,012	2,956,285,296
KAPITALI DHE DETYRIMET		31,204,001	(93,587,591)
Kapitali			
Kapitali aksionar	7	31,204,000	31,204,000
Sistemime në llogarime e kapitalit			
Rezerva të tjera		-	-
Rezerva ligjore		-	-
Fitime të rimbartura		(124,791,591)	(54,298,985)
Fitimi i ushtrimit		124,791,592	(70,492,606)
		31,204,001	(93,587,591)
Interesat e pakicës në Kapital		-	-
Totali i kapitalit			
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë		-	-
Tatimi i shtyre mbi fitimin		-	-
Gante, te ardhura të shtyra e të tjera detyrime		-	-
Detyrime të tjera afatgjatë		-	-
		-	-
Detyrime afatshkurtra		3,003,629,011	3,049,872,886
Hua afatshkurtra		-	-
Llogari të pagueshme	5	550,328,318	1,556,248
Detyrime ndaj punonjësve	5	3,218,695	3,174,360.0
Detyrime Tatimore	5	1,887,115	1,667,421.0
Provizione afat shkurter	6	4,371,367	
Llogari të pagueshme të tjera	5	2,443,823,516	3,043,474,857
		3,003,629,011	3,049,872,886
Totali i detyrimeve		3,003,629,011	3,049,872,886
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,034,833,012	2,956,285,296

Shenim Jashte bilancit

Energji e rezervuar 9,433,724 Leke
 inventar ekonomik (mobilje qrendi) 2778600 leke

Pasqyrat financiare të aprovuan më 20/06/2012 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori

Hartuesi i Pasqyrave Financiare



Sevina Kamberaj
 [Signature]

Drejtor Ekonomik
[Signature]
 [Signature]

Shënime shpjeguese janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lek)

II. PASQYRA TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

PASQYRA EPOZICIONIT FINANCIAR 'TEC VLORE' sh.a

	Ref	Per vitin e nbyllur me 31.12.2011	Per vitin e nbyllur me 31.12.2010
Te ardhura nga shitja	8	298,910,430	692,333
Te ardhura te tjera jo operative			-
Materiale te para dhe te konsumeshme	0		-
Shpenzime personeli	10	(56,161,260)	(46,311,394)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	11	(5,466,597)	(5,011,946)
Shpenzime te tjera	9	(112,290,990)	(7,532,335)
Fitimi operativ		124,991,583	(58,163,542)
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara(neto)		-	-
Te Ardhura/Shpenzime financiare Neto	12	55,697	(12,329,064)
Total shpenzime financiare		55,697	(12,329,064)
Fitimi para tatimit		125,047,281	(70,492,606)
Efektet e tatimit te shtyre			
Shpenzimi i tatimit nbi fitimin	13	(255,689)	-
Fitimi i vitit		124,791,592	(70,492,606)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Fitimi qe i atribuohet aksionareve te kompanisë nënë		-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse qe i përket aksionareve te kompanisë nënë	-	124,791,592	(70,492,606)


Pasqyrat financiare u aprovuan më 20.06.2012 dhe u firmosën si më poshtë:


Administratori

MALIQ HANU



Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Denise Kamberaj


Dajton Elqumit


(Shumat janë të shprehura në Lek)

III. PASQYRA E NDRYSHIMIT TE KAPITALI

Kapitali aksionar që i përket aksionerëve të shoqërisë (pakonsoliduar)

	Kapitali i aksionar	Rezerva statutore	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Rezerva	Fitimi i pashperndare	Fitimi i vitit financiar	Fitimi (humbje) e	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2009	2,000,000	0	0	0	0	(15,598,497)	(38,700,488)	(52,298,985)	(70,492,606)
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabël2010							(70,492,606)		0
Dividendët e paguar									0
Fitimi/Humbje i pashperndare						(38,700,488)			0
Rritje kapitalit aksionar	29,204,000								29,204,000
Aksione të thesarit të riblera									0
Pozicioni më 31 dhjetor 2010	31,204,000	0	0	0	0	(54,298,985)	(70,492,606)	(93,587,591)	124,791,592
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabël2011									0
Dividendët e paguar									0
Fitimi/Humbje i pashperndare						(70,492,606)			0
Rritje kapitalit aksionar	0								0
Aksione të thesarit të riblera									0
Pozicioni më 31 dhjetor 2011	31,204,000	0	0	0	0	(124,791,591)	124,791,592	31,204,001	31,204,001

Pasqyrat financiare u aprovuan më 20.06.2012 dhe u firmosën si më poshtë:



Administratori

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Dyktor. Skaracov'ic
Arjan Kumburaj
Arjan

(Shumat janë të shprehura në Lek)

IV. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	125,047,281	(70,492,606)
Rregullime për:		
Amortizimin i AAM	5,466,597	5,011,946
Amortizimi i AAJM	-	-
Amortizimi i të ardhurave të shtyra	-	-
Tatim fitimi i ushtrimit	(255,689)	-
Levizjet ne Kapitali Qarkullues	-	-
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera	33,937,561	(118,825,414)
Rritje/rënie në tepricën inventarit	345,996,036	198,630,896
Rritje/rënie në llogarite e furnitoreve	548,772,070	(4,518,470)
Rritje/rënie në llogarite te tjera te pagueshme	(599,387,312)	1,736,765
Rritje/renie ne parapagime te ardhura te shtyra	4,371,367	-
Rritje/renie ne shpenzimet e shtyra	-	-
Mjetet Monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	463,947,910	11,543,117
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
Blerja e shoqërisë së kontrolluar minus paratë e arkëtuara	-	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(2,900,136)	(9,938,438)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale ne Proces	(469,848,389)	(765,869,901)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
Interesi i arkëtuar	-	-
Dividendët e arkëtuar	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese	(472,748,525)	(775,808,339)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
Emetimi i kapitalit aksioner	-	29,204,000
Emetimi i aksioneve preferenciale	-	-
Pagesa e e kostove te emetimit te kapitalit aksioner	-	-
Rritje /Paksim nga paksimi I kapitalit aksioner	-	-
Te tjera rivleresim kapitali	-	-
Rritje/Paksim I detyrimeve te Ortakeve	-	728,390,750
Rritje /Renie nga institucionet financiare afatgjate	-	-
Dividendët e paguar	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare	-	757,594,750
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	(8,800,615)	(6,670,472)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	18,977,854	25,648,327
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	10,177,239	18,977,855

Pasqyrat financiare u aprovuan më 20.06. 2012 dhe u firmosën si më poshtë:

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Leonid Kamberogj

Ingjhar Shkencet

1) Informacion i Përgjithshëm

Shoqëria "TERMOCENTRALI Vlore" sh.a (shoqëri anonime), është krijuar juridikisht me vendimin e gjykates nr.3862,date 18/06/2007, regjistruar më daten 22/12/2007 ne QKR . Selia e shoqërisë ndodhet ne Vlore, NIPT:K72422003G.Kapitali I nenshkruar I saj eshte 31,204,000 leke I ndare ne 2000 aksione me vlere nominale 1000 leke aksioni ne momentin e krijimit te shoqërisë si dhe shtesa e kapitalit prej 29,204,000 leke bazuar ne vendimin ate 13/07/2010 miratuar nga pronari. Aksionet zoterohen 100% nga KESH sha.

Aktiviteti: Prodhim ,import,eksport dhe furnizimi i energjise elektrike.Nr.i Punonjesve sipas listepageses se muajit dhjetor 2011 eshte 57 punonjes.

Shoqëria drejtohet nga Keshilli Mbikqyres i emeruar nga KESH sh.a

Keshilli Mbikqyres perbehet:

1. Robert Niko	Kryetar
2. Tare Hamo	N/kryetar
3. Marialis Celo	Anetar
4. Klodian Gumeni	Anetar
5. Brunilda Muca(Veizi)	Anetar
6. Gezim Shahini	Anetar
7. Kreshnik Marku(Ndoka)	Anetar

Veprimtaria e perditeshme e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj Maliq Haxhiaj.

Gjate periudhes 01.01.2011 deri me 31.12.2011 shoqëria ka kryer aktivitetin e saj ne perputhje me objektin e krijimit te saj.

2) Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare jane përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF, Standardet e reja dhe të rishikuara të adoptuara nga Shoqëria)

Shoqëria ka adoptuar SNRF-të e reja dhe të rishikuara që janë paraqitur më poshtë :

- **SNRF 7 'Instrumentat Financiarë – Dhënie Informacioni' (I rishikuar)** – në fuqi nga 1 Janari 2009. Standardi i rishikuar kërkon informacion shtesë për matjen me vlerën e drejtë dhe riskun e likuiditetit. Mënyra e matjes me vlerë të drejtë duhet të analizohet në shënimet shpjeguese sipas burimeve të kontributeve duke përdorur hierarkinë me tre nivele të vlerës së drejtë, sipas klasave, për të gjithë instrumentat financiare të njohur me vlerë të drejtë. Për më tepër, kërkohet informacion për rakordimin mes gjendjes në fillim dhe gjendjes në fund për nivelin e tretë të matjes me vlerë të drejtë, si dhe për transferimet e rëndësishme midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë. Amendimet qartësojnë kërkesat për shënimet në lidhje me riskun e likuiditetit përsa i përket transaksioneve me derivativët dhe aktivet e përdorura për manaxhimin e likuiditetit. Informacioni shpjegues për vlerën e drejtë dhe riskun e likuiditetit paraqitet në Shënimin nr.30 dhe nuk ndikohet në mënyrë të rëndësishme nga rishikimi i standardit
- ◆ **SNK 1 (rishikuar), 'Paraqitja e pasqyrave financiare'** - në fuqi nga 1 Janar 2009. Standardi i rishikuar ndan ndryshimet e pronarëve dhe të jo-pronarëve në kapital. Pasqyra e ndryshimit në kapital përfshin vetëm detajet e transaksioneve me pronarët, ndërsa ndryshimet në kapitalin jo-pronar, paraqiten në rakordimin e çdo elementi të kapitalit. Standardi prezanton dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse: ku paraqiten të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura si në një pasqyrë të vetme, ashtu dhe në dy pasqyra të lidhura më

(Shumat janë të shprehura në Lek)

njëra-tjetrën. Shoqëria ka zgjedhur të paraqesë një pasqyrë të vetme të të ardhurave gjithëpërfshirëse. Informacioni krahasues është riparaqitur konform standardit të ri. Duke qenë se ndryshimi në politikën kontabël ndikon vetëm mbi aspekte të paraqitjes, nuk ka ndikim mbi fitimin per aksion. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ndryshimet e kërkesave për dhënie informacioni.

◆ Standartet e reja, amendimet e standarteve dhe interpretimeve të paraqitura më poshtë, janë të detyrueshme për herë të parë për pasqyrat financiare për vitin që fillon me 1 Janar 2009, por nuk janë aktualisht të rëndësishme për Shoqërinë.

- SNRF 1 Adoptimi i Standardeve Ndërkombetare të Raportimit Financiar për herë të parë dhe SNK 27 Pasqyrat financiare të rishikuara dhe individuale (Amenduar)
- SNRF 2 Pagesat e Bazuar në aksione: Kushtet dhe Anullimet e Kushtëzimeve
- SNRF 8 Segmentet e Shfrytëzimit
- SNK 23 Kostot e Huamarrjes (Rishikuar)
- SNK 32 Instrumentat financiarë: paraqitja dhe SNK 1 Instrumentat financiarë të kthyeshëm dhe detyrimet që lindin nga likuidimet
- KIRFN 9 Rivlerësimi i instrumentave derivativë të perfshire dhe SNK 39 Instrumentat financiarë: Njohja dhe Matja
- KIRFN 13 Programi i besnikërise ndaj klientit
- KIRFN 15 Marrëveshjet për ndërtimin e pasurive te paluajtshme
- KIRFN 16 Mbrojtjet e investimve neto në operacionet e huaja
- KIRFN 18 Transferimi i aktiveve nga klientët
- BSNK Projekti vjetor për përmirësim nga Maj 2008.

Në Maj të 2008 BSNK përfundoi paketën e parë të ndryshimeve në standartet e saj, kryesisht me qëllim largimin e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit. Datat efektive të përmirësimeve janë të ndryshme dhe më e hershmja është ajo për vitin financiar duke filluar nga data 1 Janar 2009.

- **SNRF 5 Aktivët Afatgjata që mbahen për Shitje dhe Operacionet Jo të vijueshme.**
Amendimi sqaron se të gjitha pasuritë e një dege dhe detyrimet, janë klasifikuar si të mbajtur për shitje, sipas SNRF 5, edhe në rastin kur subjekti do të mbajë një interes per jo-kontrollin në degë pas shitjes.
- **SNRF 7 Instrumentet financiare: Shënime shpjeguese**
Ky amendim heq referencën 'të ardhurat totale të interesit' si pjesë përbërëse e shpenzimeve financiare.
- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare**
Ky amendim sqaron se aktivet dhe detyrimet e klasifikuara si të mbajtura për tregti në përputhje me SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja nuk janë klasifikuar automatikisht si afatshkurtra në bilanc.
- **SNK 8 Politikat Kontabile, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet**
Ky amendim sqaron se vetëm udhëzimi i implementimit që është një pjesë integrale e SNRF është i detyrueshëm kur zgjedhen politikat kontabile.
- **SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese**
Ky amendim sqaron se dividendët e deklaruar pas përfundimit të periudhës raportuese nuk janë detyrime.
- **SNK 16 Aktivët afatgjata materiale**
Ky amendim sqaron se aktivet afatgjata materiale të mbajtura për dhënie me qira, që shiten në mënyrë rutinë gjatë aktivitetit të zakonshëm të biznesit pas marrjes me qira, transferohen në inventar kur nuk janë me qira dhe janë mbajtur për shitje.

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Të ardhurat nga shitja paraqiten më pas si të ardhura. SNK 7 Pasqyra e fluksit të parave është rishikuar gjithashtu, që të kërkojë që pagesat e parave për të prodhuar ose përfutur aktive të tilla do të klasifikohen si flukse të parasë nga aktivitetet operative. Flukset monetare hyrëse nga qiratë dhe shitja pasuese e pasurive të tilla klasifikohen gjithashtu si flukse të parasë nga aktivitetet operative.

- **SNK 18 Të ardhurat**

Ky amendim zëvendëson termin "kostot direkte 'me' kostot e transaksionit" siç përcaktohet në SNK 39.

- **SNK 19 Përfitimet e punonjësve**

Ky amendim shqyrton përkufizimet e "kostot e shërbimeve të shkuara," kthimi mbi aktivet e skemës' dhe përfitimet të punonjësve ' afatshkurtra 'dhe' të tjera afatgjata, të përqëndrohen në momentin kohor në të cilin detyrimi duhet të shlyhet.

- **SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndihmën Qeveritare**

Kreditë e dhëna pa apo me norma interesi më të ulëta se ato të tregut nuk bëjnë përjashtim nga kërkesa për të ngarkuar interes. Interesi do të llogaritet për kreditë e dhëna me norma interesi më të ulëta se ato të tregut, duke qenë në përputhje me SNK 39. Diferenca ndërmjet shumës së marrë dhe shumës së zbritur kontabilizohet si një grant i qeverisë. Të aplikohet prospektivisht SNK 39 për kreditë qeveritare marrë më ose pas dates 1 Janar 2009.

- **SNK 23 Kostot e huamarrjes**

Amendimi rishikon përkufizimin e shpenzimeve të huamarrjes për të konsoliduar në një llojet e njësisve që janë konsideruar si komponentët e 'kostove të huamarrjes' - shpenzimi i interesit llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit siç përshkruhet në SNK 39.

- **SNK 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta**

Kur një njësi mëmë e konsideron një njësi të kontrolluar me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 39 në pasqyrat e saj të veçanta financiare, ky trajtim vazhdon edhe kur shoqëria e kontrolluar është klasifikuar si e mbajtur për shitje.

- **SNK 28 Investime në Pjesëmarrje**

Ky interpretim sqaron se (i) në qoftë se një pjesëmarrje është konsideruar me vlerën e drejtë, në përputhje me SNK 39, vetëm kërkesat e SNK 28, për të treguar natyrën dhe shtrirjen e kufizimeve të rëndësishme në aftësinë e pjesëmarrjes për të transferuar fonde te njësi, në formën e parave ose shlyerjen e kredive; zbatohen dhe (ii) një investim në një ortakëri është një aset i vetëm me qëllimin e kryerjes së testit të zhvlerësimit - duke përfshirë çdo anulim të zhvlerësimit.

Prandaj, çdo zhvlerësim nuk është i ndarë në mënyrë të veçantë në emrin e mirë të përfshirë në bilancin e investimeve dhe çdo zhvlerësim anulohet, nëse shuma e rikuperueshme e pjesëmarrjes rritet.

- **SNK 29 Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste**

Ky amendim rishikon referencën lidhë me përjashtimin për të matur aktivet dhe detyrimet me kosto historike, dhe thekson si shembull aktivet afatgjata materiale, në vend që të lihet të kuptohet se është një listë përfundimtare.

- **SNK 31 Interesi në Sipërmarrjet e Përbashkëta**

Ky amendim sqaron se në qoftë se një sipërmarrje e përbashkët është konsideruar me vlerën e drejtë, në përputhje me SNK 39, aplikohen vetëm kërkesat e SNK 31 që lidhen me angazhimet e sipërmarrjes dhe sipërmarrjet e përbashkëta, si dhe përmbledhjen e informacionit financiar në lidhje me asetet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet .

- **SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm**

Ky amendim sqaron se fitimet për çdo aksion janë paraqitur në raportet e ndërmjetme financiare, nëse një entitet është brenda fushëveprimit të SNK 33.

- **SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve**

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Ky amendim sqaron se kur flukset e skontuara të parave janë përdorur për vlerësimin e "vlerës së drejtë minus kostot e shitjes", të njëjtat shpjegime kërkohen si kur flukset e skontuara të parave janë përdorur për vlerësimin e "vlerës në përdorim".

- **SNK 38 Aktivitet Jomateriale**

Shpenzimet për reklama dhe aktivitete promovuese njihen si shpenzim kur njësia ose ka të drejtë përdorimi të të mirave ose ka përfutur shërbimet.

Nje parapagim mund të njihet vetëm në rast se pagesa është bërë në avancë për të fituar të drejtën e përdorimit të të mirave ose marrjes së shërbimeve.

- **SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe matja**

Sqaron se ndryshimet në lidhje me derivatët - veçanërisht derivatet e percaktuar apo ri-caktuar si instrumente mbrojtjeje pas njohjes fillestare - nuk janë riklasifikime. Kështu, një derivat mund të hiqet nga, ose të përfshihet në klasifikimin, 'vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes' pas njohjes fillestare. Në mënyrë të ngjashme, kur mjetet financiare janë riklasifikuar si rezultat i ndryshimit nga një kompani sigurimesh i politikës së saj kontabël në përputhje me paragrafin 45 të SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve, ky është një ndryshim në rrethana, dhe jo një riklasifikim.

Kërkon përdorimin e normës së interesit efektiv të rishikuar (në vend të normave origjinale efektive të interesit) kur rimatet një instrument borxhi pas përfundimit të kontabilitetit të mbrojtjes me vlerë n e drejtë.

- **SNK 40 Aktivitet materiale afatgjata të investuara**

Ndryshon qëllimin (dhe qëllimin e SNK 16) i tillë që prona që është duke u ndërtuar ose zhvilluar për përdorim në të ardhmen si një pronë për investim të klasifikohet si aktiv material afatgjatë për investim. Nëse një njësi nuk është në gjendje të përcaktojë vlerën e drejtë të një prone në ndërtim, por pret të jetë në gjendje të përcaktojë vlerën e saj të drejtë në përfundim, investimi në ndërtim e sipër do të matet me kosto deri sa të mund të përcaktohet vlera e drejtë ose kur ndërtimi të ketë përfunduar.

Sqaron se vlera e mbetur e aktivitet material afatgjatë të marrë me qira është vlerësimi i marrë plus ndonjë detyrim i njohur.

- a) **Baza e Matjes dhe e Ndërtimit të Pasqyrave Financiare**

Pasqyrat financiare përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurat dhe shpenzimet, Pasqyra e fluksit të parasë, Pasqyra e ndryshimeve në kapital si dhe shënimet shpjeguese.

- Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike
- pronat e mbajtura për qëllime investimi janë matur me vlerë të drejtë
- detyrimet nga marrëveshjet për pagesa të bazuara në aksione që shlyhen në mjete monetare janë matur me vlerë të drejtë.
- instrumentet derivative financiare janë matur me vlerë të drejtë
- instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet financiare të vlefshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë

- b) **Monedha Funktionale dhe Raportuese**

Zerat e perfshire ne pasqyrat financiare jane vleresuar ne monedhen shqiptare Leke, e cila eshte edhe monedha funksionale e Shoqerise. Shoqeria raporton pasqyrat financiare ne Leke.

- c) **Përdorimi i Vlerësimeve dhe Gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të

(Shumat janë të shprehura në Lek)

raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3) Përmbledhje e Politikave të Rëndësishme Kontabël

Politikat kontabël paraqitur më poshtë dhe ne vazhdimësi të politikave të përdorura si pjesë e Grupi Kesh.sh.a (konsolidohet), ato janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme.

a) Transaksionet në Monedhë të Huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën përkatëse funksionale duke përdorur kurset e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehur në monedha të huaja në datën e raportimit rikonvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së përcaktimit të vlerës së drejtë.

Kurset kryesore të këmbimit ndaj Lekut janë:

	2011	2010
Kurse e këmbimit		
Euro/Leke	138.93	138.77
USD/ Leke	107.54	104

b) Aktivitet Afatgjata Materiale

Njohja dhe matja

Zerat e llogarise toka, ndertesa, makineri dhe pajisje të telekomunikacionit janë të paraqitura me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Te gjitha aktivitet e tjera afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivitet.

Kostoja e aktiveve të kualifikuara përfshin kostot e interesit të kryera gjatë periudhave të ndertimit, nëse ka, bazuar në normen mesatare të matur të huadhenies.

Software i blere që është thelbësor për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndertimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndertimi tij.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afat-gjate materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivitetit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Amortizimi kalohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Normat vjetore të amortizimit të përdorura, bazuar në Ligjin 8438 datë 28.12.1998 "Per tatimin mbi të ardhurat" dhe Udhezimit të Ministrisë së Financave No.5 datë 30.01.2006 janë si më poshtë:

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %		Metoda e Llogaritjes
	2011	2010	
Ndertesat	5	5	
Instalime Teknike (Linja)	5	5	
Makineri e paisje	20	20	Vlera e mbetur
Mjete transporti	20	20	
Mobilje orendi	20	20	
Pajisje elektronike	25	25	

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

Në vitin 2010 ka ndryshuar mënyra e llogaritjes fiskale të amortizimit për zerin Ndertesat e Linja e cila ka ndryshuar llogaritja mbi bazën lineare në vitin 2009 në llogaritjen mbi vlerën e mbetur për vitin 2010.

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale për llogaritet mbi bazën e jetës ekonomike të dobishme mesatare. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Vlera e drejte

Shoqëria i paraqet AAM në bilancin e vitit 2011 me vlerën e drejte.

Cregjistrimi

Një ze i aktiveve afatgjata materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atehere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ

c) Aktivet Jomateriale

Shpenzimet e kërkimit dhe zhvillimit

Shpenzimet e kryera për zhvillimin e projekteve regjistrohen si aktive të paprekshme. Sipas SNK 38 kjo lejohet vetëm nëse është e mundshme që projekti do të ketë sukses, duke konsideruar mundësinë komerciale dhe teknologjike, dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme.

d) Inventarët

Inventari paraqitet me vlerën me të ulët mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përlogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit, pa koston e përlogaritur të perfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

Kostot e inventarit janë përlogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese

e) Instrumentat Financiarë

Njesia Ekonomike zotëron vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë, duke përfshirë llogaritë të arkëtueshme, mjete monetare, huamarrje dhe huadhënie, dhe llogaritë të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto

(Shumat janë të shprehura në Lek)

transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat jo me vlerë të drejtë kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqëria ndaj flukseve të parasë së aktivitetit financiar ose kur kompania transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontroll ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- ***Paraja dhe mjetet monetare ekuivalente me to***

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, depozitat në para me bankat, investime të tjera tejet likuide me maturim fillestar prej tre ose më pak muajsh.

- ***Llogaritë e arkëtueshme***

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

- ***Llogaritë e pagueshme***

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

- ***Huadhënie dhe huamarrje***

Pas njohjes fillestare, huadhëniet dhe huamarrjet paraqiten me kosto të amortizuar dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në interesin efektiv të çdo diference midis kostos dhe vlerës së riblerjes përgjatë periudhës së huamarrjes.

- ***Të tjera***

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme, duke përfshirë ndërtimet në proces, vlerësohet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën e interesit në treg në datën e raportimit.

Instrumentat financiarë janë klasifikuar si detyrime afat-shkurtra përveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyrjes së detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

f) Të ardhura dhe Shpenzime Financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

g) Kapitali Aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

h) Tatimi mbi Fitimin dhe Tatimi i Shtyrë

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, në këtë rast tatimi njihet në kapital.

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumat e përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin e miratuar në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme tatimore të vlefshme që diferencat e përkohshme mund të përdoren kundrejt tyre. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

i) Përfitimet e Punonjësve

- ***Fondet e sigurimeve shoqërore, pensionale dhe të shëndetit***

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Shoqëria është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

- ***Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës***

Sipas kontratës kolektive të punës, në rast të përfundimit të kontratës së punësimit pasi punonjësi ka arritur moshën e kërkuar me ligj për daljen në pension, pavarësisht nga arsyeja e përfundimit, punonjësi ka të drejtën e një kompensimi prej 2 pagash mujore bruto.

Përfitimet në përfundimin e kontratës njihen si shpenzim kur Shoqëria është përkushtuar pa ndonjë mundësi realiste të rreheje ndaj një plani formal dhe të detajuar që të përfundojë kontratën përpara datës normale të daljes në pension ose të sigurojë përfitimet e përfundimit si rezultat i një oferte për të përkrahur sigurimin vullnetar. Përfitimet në përfundimin e kontratës për sigurimet vullnetare njihen si një shpenzim nëse Shoqëria ka bërë një ofertë për sigurimin vullnetar dhe është e mundshme që oferta do pranohet dhe numri i pranimeve mund të matet në mënyrë të besueshme.

j) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim të tërthortë ligjor i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkohej flukse dalëse parash për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të detyrimit.

k) Njohja e të Ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqëria që rezultojnë në rritje të kapitalit gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit në tij të kontributeve të aksionerëve në kapital. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve.

Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet. Kur shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, Shoqëria i njeh të ardhurat duke u bazuar në faturat e lëshuara për furnizimin me energji. Shuma e të ardhurave nuk konsiderohet si e matshme me besueshmëri derisa nuk janë zgjidhur të gjithë kushtëzimet në lidhje me shitjen. Shoqëria bazohet në rezultatet historike, duke mbajtur parasysh llojin e klientit, tipin e transaksionit dhe specifikimet e çdo marrëveshjeje, për të kryer vlerësimet e veta.

(Shumat janë të shprehura në Lek)

- **Shitja e energjisë**

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në sasinë aktuale të energjisë elektrike të shitur.

l) Çmimi energjise

ERE ka aprovuar çmimin e shitjese se energjisë brenda kontekstit te modelit te tregut ku Shoqëria optimizon aktivitet e saj dhe portofolin e kontratave nëpërmjet një metode bazuar në analiza të hollësishme të pozicionit të ofertës dhe kërkesës dhe në vlerësime të vazhdueshme.

m) Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiramarrësi klasifikohen si të qira operative. Pagesat e qirave të zakonshme (duke përjashtuar stimuluesit e vendosur nga qiramarrësi) njihen me metodën lineare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së qirasë. Shpenzimet për keestet minimale të qirase llogariten dhe evidentohen në përpjestim me kohën e maturimit të qirase, përgjate afatit të qirase, pavarisht nga koha dhe shumat e paguar në fakt.

n) Shpërndarja e Dividentit

Shpërndarja e dividendëve për aksionerët e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare të Shoqërisë si detyrim i periudhës në të cilën janë aprovuar nga aksionerët e Shoqërisë.

Menaxhimi i rrezikut financiar

Paraprakisht theksojme se menaxhimi i çfare do lloj rrishtu është lidhur domosdoshmerisht me Grupin KESH sh.a.

Objektivat kryesorë të funksionit të menaxhimit të rrezikut janë përcaktimi i kufijve të rrezikut dhe sigurimi që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe atij ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar këto rreziqe.

Zhvillimet aktuale

Shoqëria vepron në kushtet e një krize ekonomike dhe financiare globale dhe që zhvillohet në mënyrë dinamike. Zgjerimi i saj i mëtejshëm mund të rezultojë në pasoja negative mbi pozicionin financiar dhe ekonomik. Drejtimi i shoqërisë kryen monitorim të rregullt mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe mbi zhvillimin e tregjeve financiare.

Bazuar në këto, menaxhimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve si dhe kërkon të implementojë masa të përshtatshme në lidhje me kredinë, tregun (kryesisht normat e interesit), dhe riskun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike.

4.1 Rreziku i kredisë

Shoqëria nuk është ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë i cili është rreziku që një palë në një instrument financiar të shkaktojë një humbje financiare ndaj palës tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi.

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut (çmimet e mallrave të energjisë), kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit shoqëria është ekspozuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive për ndryshime të ardhshme të çmimeve ose normave të tregut. Shoqëria nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të çmimit të instrumenteve të kapitalit pasi nuk mban aktive financiare që të përfshijnë instrumente të kapitalit në datën e bilancit.

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Për të menaxhuar rrezikun, Shoqëria optimizon aktivet e saj dhe portofolin e kontratave nëpërmjet një metode bazuar në analiza të hollësishme të pozicionit të ofertës dhe kërkesës dhe në vlerësime të vazhdueshme të tregjeve lokale në të cilat ajo operon.

Politika nuk nënkupton mbrojtjen e një pjese të ekspozimit.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të çmimeve të energjisë .

Rreziku është kryesisht në faktin që çmimet e tregut për energji do të ndryshojnë midis kohës në të cilën çmimet e shitjes janë fikse apo tarifata janë të përcaktuara dhe kohës në të cilën përcaktohet kosto e prokurimit përkatës, duke zvogëluar në këtë mënyrë marzhet e pritshme apo duke rezultuar në shitje pa fitim.

Paparashikueshmëria e çmimeve të energjisë, veçanërisht me pasigurinë e regjimeve të ardhshme të tregtisë, vështirëson llogaritjen e parashikimeve të besueshme për të mbështetur vendimet për investime duke çuar në kthyeshmëri potenciale më të vogël se ajo e pritshme.

4.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndeshura në aktivitetin e saj të zakonshëm.

4.4 Vlerat e drejta

Vlera e drejtë është shuma për të cilën mund të shkëmbehet një instrument financiar në një transaksion të zakonshëm mes palëve të mirëinformuara, e që nuk përbën një shitje të detyruar ose likuidim, dhe përfaqësohet më së miri nga një çmim i vlerësuar në një treg aktiv.

4.4.1 Aktivet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e huave dhe llogarive të arkëtueshme supozohet se është e përafërt me vlerën e tyre kontabël duke qenë se ato janë instrumente afat-shkurtër që nuk mbartin interes.

4.4.2 Detyrime të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e detyrimeve të ripagueshme në të parë supozohet se është shumë e përafërt me vlerën kontabël. Vlerat kontabël të llogarive të pagueshme e të tjera janë të përafërta me vlerat e tyre të drejta.

4.5 Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e shoqërisë (ne pronesi të KESH sh.a) në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e shoqërisë për vijimësi të biznesit me qëllim të mundësimin të kthyeshmërisë për aksionarët dhe të përfitimeve për grupe të tjera të interesit dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të reduktuar koston e kapitalit. Shoqëria (vendimmarrja) mund të përcaktojë shumën e dividendëve të paguar, kthyeshmërinë e kapitalit ndaj aksionarëve, të emetojë aksione të reja apo të shesë aktive për të reduktuar huamarrjen me qëllim që të ruajë apo për të ndryshuar strukturën e kapitalit.

(Shumat janë të shprehura në Lek)

Vlerësime dhe Gjykime të Rëndësishme Kontabël

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë të bazuara në eksperiencën e kaluar dhe në faktorë të tjerë, që përfshijnë ngjarje që priten të ndodhin në të ardhmen. Këto vlerësime dhe gjykime mendohet të jenë të arsyeshme në rrethanat e dhëna.

a) *Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë*

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë të cilët nuk janë tregtuar në një treg aktiv (p.sh. huatë ndaj punonjësve dhe kreditë) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të zgjedhur një shumëllojshmëri metodash dhe për të bërë supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet ekzistuese të tregut në çdo datë bilanci. Për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk tregtohen në tregje aktive, shoqëria përdor analizën e skontimit e flukseve të parasë.

b) *Aktive të qëndrueshme të trupëzuara*

Drejtuesit e shoqëria (me vendimarrje) përcakton jetëgjatësinë e pritshme dhe normat e zhvlerësimit, lidhur me aktivet e qëndrueshme të zotëruara. Ky vlerësim bazohet në ciklin e projektuar të jetës së aktivit. Ai mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i ndryshimeve në mjedisin e tregut. Këto ndryshime në jetën e aktiveve, mund të çojnë në rregullime të rëndësishme të vlerës së tyre kontabël neto.

c) *Rënia në vlerë e aktiveve financiare (huave dhe llogarive të arkëtueshme)*

Shoqëria bazohet në SNK 39 për të përcaktuar se kur një aktiv financiar është i rënë në vlerë. Ky përcaktim kërkon një gjykim të rëndësishëm. Për të gjykuar mbi të, shoqëria vlerëson, midis faktorëve të tjerë, kohëzgjatjen dhe nivelin në të cilin vlera e drejtë e një investimi është më e vogël se kosto e tij dhe flukset operative dhe financiare të parasë.

V. Shenimet Shpejguese

1. Mjetet Monetare

Gjendjet e “Mjete Monetare ” te 31.12. 2011 krahasuar me 31.12.2010:

Emertimi i Llogarise	Monedha	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010	
		Ekuivalenca ne		Ekuivalenca	
		leke	Vlefta	ne leke	Vlefta
Raiffeisen	Leke	1,166,338.03		12,123,257.69	-
Intesa SP	Leke	6,204,151.36		1,143,069.73	-
Intesa SP	Euro	2,792,308.22	20,098.67	738,596	5,207.0
Intesa SP	USD			0	-
Prokredit	Leke	-		1,176	-
B.K.T	Leke	5,637.48		733.46	-
Tirana Bank	Leke	9,303.97	-		
Banka Popullore	Leke	-500.34			
				4,967,863.50	-
Totali		10,177,239		18,974,696	

Mjete monetare banke	Monedha	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010	
		Ekuivalenca ne		Ekuivalenca	
		leke	Vlefta	ne leke	Vlefta
Llogari rrjedhese	leke	7,384,930.50	0	18,236,100	
Llogari rrjedhese	Euro	2,792,308.22	20,098.67	738,596.00	5,207.00
Totali		10,177,239		18,974,696	

Mjete monetare ne arke	Monedha	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010	
		Ekuivalenca ne		Ekuivalenca	
		leke	Vlefta	ne leke	Vlefta
Llogari rrjedhese	Euro	0		284	2.05
Llogari rrjedhese	Leke	0		2,874	
		0		3,158	

2. Të Tjera Për Tu Arketuar

Aktive te tjera Financiare afatshkurter	Monedha	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Technimont	leke	2,451,804	2,451,804
Tatim mbi fitimin	leke	-	110,000
Shteti – TVSH e zbritshme	leke	446,927,758	480,622,220
Debitore te ndryshem	leke	189,882	322,981
Totali		449,569,443	483,507,004

(Shumat janë të shprehura në Lek)

3. Inventaret

Gjendjet e “Inventareve ” te 31.12. 2011 krahasuar me 31.12.2011::

Emertimi i Llogarise	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010
	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Lende e para	leke	1,117,919,474	1,463,915,510
Prodhimi ne proces	leke	-	-
Produkte te gatshme	leke	-	-
Mallra per rishitje	leke	-	-
Parapagime per furnizime	leke	-	-
Totali		1,117,919,474	1,463,915,510

(Shumat janë të shprehura në Lek)

4. Aktive Afatgjata Materiale

Pershkrimi	Makineri dhe pajisje	Mjete Transporti	Pajisje informatike	Inventar ekonomik	Total
Vlera bruto e AAM me 31.12.2010	41,750,255	-	1,059,970	842,000	43,652,225
Shtesa/paksime nga vleresimi	1,002,000	4,931,197	353,183	947,731	7,234,111
Shtesa gjate 2011					-
Transferuar ne inventar					-
Shitje					-
Nxjerrje jashte perdorimit	(4,898,520)		(353,183)	(1,853,731)	(7,105,434)
Sistemime	4,898,520		353,183	1,853,731	7,105,434
Sistemime					
AAM me 31 dhjetor 2011	42,752,255	4,931,197	1,413,153	1,789,731	50,886,336
Amortizimi i akumuluar 31.12.2010	17,208,439		341,706	101,173	17,651,318
Shtesa/paksime nga vleresimi	4,960,435	39,815	200,203	266,144	5,466,597
Amortizimi I vitit 2011					-
Transferime nga inventari					-
Shitje					-
Nxjerrje jashte perdorimit					-
Amortizimi I akumuluar I makinave te marra nga KESH		4,333,975			4,333,975
Sistemime	(760)			760	-
Amortizimi I akumuluar, 31 dhjetor 2011	22,168,114	4,373,790	541,908	368,077	27,451,890
Vlera neto e AAM 2011	20,584,141	557,407	871,245	1,421,654	23,434,446
Vlera neto e AAM 2010	24,541,816		718,264	740,827	26,000,907

Investime Ne Proces

Aktive te tjera afatgjata (ne proces)	Monedha	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
AAM ne PROCES	Leke	1,433,732,410	963,884,021.00
Totali		1,433,732,410	963,884,021

Ne kete post paraqitet kosto progresive e Termocentralit (perfshire cdo lloj kostoje qe ka lidhje me investimin sipas SNK). Si vijon paraqitet e detajuar kjo llogari.

6.Detyrimet Afatshkurter (Huate dhe Parapagimet)

Gjendjet e "Huate dhe Parapagimet " te 31.12. 2011 krahasuar me me 31.12.2010:

Huate dhe Parapagimet	Monedha	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Furnitore te papaguar	Leke	550,328,318	1,556,248
Per T`u paguar _Personeli	Leke	3,218,695	3,174,360
Detyrime tatimore	Leke	1,887,115	1,667,421
Hua te tjera	Leke	2,443,823,516	3,031,620,212
KESH (akt rakordimi)	Leke	-	11,854,645
Totali		2,999,257,644	3,049,872,886

Per t`u paguar _Personeli	Monedha	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Per t`u paguar _Pagat e te tjera te .	leke	3,058,945	3,014,610
Per t`u paguar _Pagat e keshillit n.	leke	159,750	159,750
Totali		3,218,695	3,174,360

Detyrime ndaj buxhetit	Monedha	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	leke	1,041,617	969,928
Tatim mbi te ardhurat (TAP)	leke	699,809	697,493
Tatim ne burim	leke	0	-
Tatim fitmi	leke	145,689	-
Tvsh per tu paguar	leke	-	-
Totali		1,887,115	1,667,421

(Shumat janë të shprehura në Lek)

<i>Hua te tjera</i>	<i>Monedha</i>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>31 Dhjetor 2010</u>
		<i>Vlera ne leke</i>	<i>Vlera ne leke</i>
<i>Projektet (M)</i>	<i>leke</i>	123,900	123,900
<i>Financime me KESH (D)</i>	<i>leke</i>	2,153,795,645	2,802,988,543
<i>Mardhenia me DEK (Kontabilitetit)</i>	<i>leke</i>	18,231,507	4,548,909
<i>Financime me KESH (D)</i>	<i>leke</i>	271,672,464	223,933,993
<i>Njesia e TL Fier (KESH sh.a.).</i>	<i>leke</i>	-	-
<i>Vlera e grantit</i>	<i>leke</i>	-	(692,333)
<i>KESH (akt rakordimi)</i>	<i>leke</i>	-	12,546,978
<i>Te pagueshme sindikatat</i>	<i>leke</i>	-	24,867
<i>Totali</i>		2,443,823,516	3,043,474,857

7.Provizione Afashkurter

Provizione Afashkurter	Monedha	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>31 Dhjetor 2010</u>
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Provizione Afashkurter		4,371,367	-
Totali		4,371,367	-

8.Kapitali Aksioner dhe Rezervat

Shoqeria ka kapital te nenshkruar 2,000,000 leke.Gjate vitit 2011 eshte bere zmadhim kapitali prej 29,204,000 leke bazuar ne vendimin date 13/07/2010 i Kesh sh.a.pronar i vetem i TEC SH.A

Aksioner i vetem i shoqerise eshte Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
Me poshte gjeni te **detajuar te gjitha llogarite e kapitalit te vet.**

	Kapitali i aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi i pashperndare	Fitimi (humbje) e vitit financiar	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2009	2,000,000	0	0	(15,598,497)	(38,700,488)	(52,298,985)
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabël2010					(70,492,606)	(70,492,606)
Dividendët e paguar						0
Fitimi/Humbje i pashperndare				(38,700,488)	38,700,488	0
Rritje kapitalit aksionar	29,204,000					29,204,000
Aksione të thesarit të riblera						0
Pozicioni më 31 dhjetor 2010	31,204,000	0	0	(54,298,985)	(70,492,606)	(93,587,591)
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabël2011					124,791,591	124,791,592
Dividendët e paguar						0
Fitimi/Humbje i pashperndare				(70,492,606)	70,492,606	0
Rritje kapitalit aksionar	0					0
Aksione të thesarit të riblera						0
Pozicioni më 31 dhjetor 2011	31,204,000	0	0	(124,791,591)	124,791,591	31,204,001

(Shumat janë të shprehura në Lek)

9.Te Ardhurat

Te ardhurat	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010
	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Te ardhurat nga shitjet	leke	0	-
Te ardhura nga veprimtarite e shfrytezimit	leke	298,910,430	692,333
Ndyshimet ne invent.e prod.gatshem/proces	leke		-
Totali		298,910,430	692,333

10.Shpensime të Tjera

Shpenz. Te tjera nga vep.e shfrytezimit	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010
	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Blerje te tjera	Leke	(6,699,408)	(1,043,786)
Mirmbajtje Riparime	Leke	-	(17,000)
Sherbime te tjera	Leke	(100,124,859)	(2,068,778)
Publicitet, reklama	Leke	(396,000)	-
Personel jashtë njesisë	Leke	(2,130,000)	(2,130,000)
Transferime, udhëtime, dieta	Leke	(1,272,500)	(354,648)
Shpensime postare dhe telekomunikimi	Leke	(422,902)	(606,065)
Shpensime transpoti	Leke	(1,068,332)	(608,273)
Shpensime për shërbimet bankare	Leke	(125,413)	(67,520)
Shpensime për pritje dhe përfaqësime	Leke	(51,590)	(25,099)
Firot ligjore te benzolit	Leke	-	(611,166)
Tjere		14	-
Totali		(112,290,990)	(7,532,335)

11.Shpensime Personeli

Kostot e punesimit	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010
	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Pagat e personelit e te tjera te lidhura me pagz	leke	(48,889,416)	(40,321,995)
Sigurime shoqerore	leke	(7,271,844)	(5,989,599)
Totali		(56,161,260)	(46,311,594)

12.Shpensimet per Amortizimin

Amortizimi	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010
	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Amortizimi dhe Zhvleresimet	leke	(5,466,597)	(5,011,946)
Totali		(5,466,597)	(5,011,946)

(Shumat janë të shprehura në Lek)

13. Te Ardhura dhe Shpenzime Financiare

Te ardhurat dhe shpenz. Financiare	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010
	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Te ardhura dhe shpenzime nga interesat	leke	-	222,586
Fitimet (Humbjet) nga kursi i kembimit	leke	(23,925)	(12,551,650)
Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare	leke	79,622	-
Totali		55,697	(12,329,064)

Rezultati nga kursi i kembimit	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010
	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Te ardhura nga diferencat e kursit	leke	388,429	
Shpenzime nga diferencat e kursit	leke	(412,354)	(12,551,650)
Totali		(23,925)	(12,551,650)

14. Fitim/ Humbje dhe Rezultatit Tatimore

Rezultati tatimor	31 Dhjetor 2011		31 Dhjetor 2010
	Monedha	Vlera ne leke	Vlera ne leke
Fitimi para tatimit	leke	125,047,281	(70,492,606)
Shpenzime te panjohura	leke	591,315	25,100
Fitimi Fiskal	leke	125,638,596	(70,492,606)
Humbja e mbartur	leke	(123,081,705)	
Fitimi fiskal		2,556,891	
Tatim fitimi (10 %)	leke	(255,689)	-
Fitimi /Humbje Neto		124,791,592	(70,492,606)

15. Ngjarje pas Datës së Bilancit. Nuk kemi asgje me rendesi per te shenuar pas dates se mbylljes se Pasqyrave Financiare me 31.12.2011.



Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Donina Kambovoj

Donina Kambovoj